



BASHKIA BERAT

DREJTORIA E PLANIFIKIMIT URBAN , LEJEVE DHE MONITORIMIT TE
INVESTIMEVE

RELACION TEKNIK

OBJEKTI:" REHABILITIMI URBAN I SHESHIT "JANI VRUHO"

Punoi: Ark.Frenci Ceca

ING.Valentina karabina

BERAT 2024

1 INFORMACION I PERGJITHSHEM MBI PROJEKTIN

□ **Titulli i Projektit: : " Rehabilitim urban I sheshit Jani Vruho" □**

- **Vendi: Berat, Shqiperi □**
- **Klienti : Bashkia Berat □**
- **Faza e Projektit: Projekt Zbatimi □**

1.1 Informacion i pergjithshem



Shqiperia ndodhet ne Europen Juglindore dhe ka nje siperfaqe prej 28.748 km². Kufizohet me Malin e Zi dhe Kosoven ne veri, Ish Republiken Jugosllave te Maqedonise ne lindje, dhe Greqine ne jug. Shqiperia shtrihet ne bregdetin lindor te detit Adriatik.

Gjatesia e pergjithshme e kufirit te Shqiperise eshte 1.094 km. Kufijte tokesore, detare, liqenore dhe lumore jane perkatesisht: 657 km, 316 km, 73 km dhe 48 km. Vija bregdetare eshte 427 km e gjate: 273 km i perkasin bregdetit te Adriatikut dhe 154 km bregdetit te Jonit.

Bazuar ne te dhenat e Rregjistrimit te Popullise ne vitin 2011, rezulton se popullsia e Shqiperise eshte 2,895,947 banore.

Terreni qe pershkruan Shqiperine eshte 70% terren malor dhe pjesa tjeter fushor, kodrinor e bregdetar. Rajonet bregdetare kane klime te bute, por me ne brendesi dhe ne veri, klima karakterizohet nga dimer i ftohte dhe vere me reshje te konsiderueshme.



Ne Shqiperi funksionojne disa modalitete te transportit si :

- **Transporti ajror civil nderkombetar**
- **Transporti hekurudhor** □
- Transporti detar**

Transporti me i rendesishem ne Shqiperi eshte Transporti Rrugor. Sipas Planit Strategjik te Transportit te hartuar ne 2011, Rrjeti Kombetar Rrugor ne Shqiperi eshte rreth 18.000 km i gjate, duke përfshirë 3.600 km rruge kombetare, 10.500 km rruge nder-urbane, dhe pjesa tjeter prej 4.000 km eshte nen juridiksionin e enteve private, kompanive, etj.

Rrjeti kombetar rrugor perbehet nga:

1. **Rrjeti Rrugor Paresor**, i cili eshte rreth 1.198 km i gjate dhe ka 9 arterie kryesore qe perbejne rrjetin baze,
2. **Rrjeti Dytësor**, i cili eshte rreth 2.083 km i gjate.

1.2 Vendndodhja e Projektit

Berati është qytet me rreth 65.000 banorë dhe njëra nga dy bashkitë e Rrethit të Beratit që bën pjesë në Qarkun e Beratit. Trojet e Beratit, sipas arkeologëve kanë qenë të banuara nga njerëz të civilizuar që nga shekulli VII para erës sonë. Rrethi Berat është i përbërë prej 2 bashki e 10 komuna.

Qyteti i Beratit është ngritur fillimisht si kështjellë, mbi kodrën shkëmbore me lartësi 187m mbi nivelin e detit, në krahun e djathtë të lumit Osum, para se ky të dalë në fushën e Myzeqesë, më e madhja e Shqipërisë. Rrethi i Beratit shtrihet në Krahinën Malore Qendrore e pjesërisht në Ultësirën Jugperëndimore të Shqipërisë, në koordinatat: gjerësi gjeografike: Veri 40 gradë 52'24"; Jug 40 gradë 29'30" (qyteti 40 gradë 41'06"); gjatësi gjeografike: Lindje 20 gradë 10'51"; Perëndim 19 gradë 44'30" (qyteti 19 gradë 56'40"). Rrethi mbulon një sipërfaqe prej 953,6 km katror (qyteti 1,6 km katror).

Rrethi i Beratit shtrihet kryesisht në një territor me reliev malor e kodrinor, me lartësi mesatare mbi nivelin e detit 455m (qyteti 58 m). Fushat shtrihen në krahun veri-perëndimor të rrethit, në luginën e Osumit, derisa ajo bashkohet me fushën e Myzeqesë. Në mjedisin natyror të Beratit dallohen: zona fushore e kodrinore e Beratit dhe e Kuçovës, mali i Tomorit (Lindje, 2417m) dhe ai i Shpiragut (Perëndim, 1218m) si edhe luginat e Osumit dhe e Tomoricës. Zona fushore dhe ajo kodrinore janë baza e zhvillimit të prodhimit bujqësor, ndërsa malet dhe luginat përfaqësojnë burime të mëdha pyjore, kullosore dhe hidrike, ende të pashfrytëzuara si potenciale të rëndësishme të zhvillimit ekonomik e mjedisor.

Berati u përket qyteteve të rrallë ku jeta fillon qysh në lashtësinë e thellë dhe vazhdon pa u ndërprerë deri më sot. Dy çekanë guri e datojnë fillimin e jetës në të para Periudhës së Bronzit (2600-1800 P. Kr.). Dëshmitë arkeologjike tregojnë se në shek. VII-VI P. Kr. Këtu është zhvilluar një vendbanim paraqytetar, me punishtet e tij të qeramikës dhe me një jetë shoqërore të diferencuar. Në kufijtë e legjendës dhe të historisë, ky vendbanim thuhet të ketë qenë Orestia e lashtë, i quajtur kështu ngaqë aty banonin një fis i pellazgëve, orestët, i pari i të cilëve ishte Oresti, i biri i Agamemnonit. Qyteti i mirëfilltë u themelua më 313-310 P. Kr. si qytet-kështjellë i Dasaretisë, i quajtur Antipatrea nga mbreti Kassandër në kujtim të gjeneralit mëkëmbës të Lekës së Madh. Ky është emri i parë i qytetit. Pas pushtimit romak në shek. II P. Kr. ai u quajt prej tyre Albanorum Oppidum (Fortesa e Arbërve). Në shek. V, nën perandorinë Bizantine, u përforcua dhe e ndryshoi emrin në Βουλγαρολις (qyteti bullgar, sllv. Belgrad) në shekullin e X[2].

Pas tronditjes që pësoi reputacioni i qytetit në vitin 1997, ka një rivendosje të imazhit të mirë, sidomos këto dy-tre vitet e fundit, kur janë shtuar ndjeshëm flukset e vizitorëve nga vendi, nga Kosova e të huaj. Vërehet një riaktivizim i traditave më të mira të qytetit kundrejt vizitorëve. Tradicionalisht në Berat vizitori ka gjetur mikpritje të veçantë, përjetimin e një ambienti të këndshëm e shlodhës, rastin që të shijojë një kuzhinë karakteristike tradicionale të kombinuar me atë moderne, ku përfshihen ulla të ullinjë e famshëm, mishi i qengjit dhe ai i gjelit të detit dhe verërat e prodhuara nga vreshtat rreth qytetit.

Degë më e zhvilluar e turizmit deri më tani ka qenë punime të artizanatit. Artizanati, për qytetin është një vlerë e trashëguar e cila mirëmbahet edhe sot në Berat në disa gjini, si: gdhendje ne dru qendistari, punime ne argjend dhe ne metale te tjera, punime ne kashte, gdhendje ne pllaka guri, punime dekorative me gur.

Vitet e fundit ka një rigjallërim të ketyre mjeshtërive. Vizitori mund të gjejë në disa dyqane gdhendje me pamje karakteristike të Beratit. Punimet e disa prej mjeshtrove të Beratit janë shpërndarë edhe jashtë vendit.[3] Në vitin 1901, Berati ishte qendër sanxhaku e varur nga vilajeti i Janinës.[4]

Turizmi është një ndër drejtimet më premtuese të zhvillimit ekonomik të Beratit. Qyteti trashëgon nga e kaluara një varg të gjatë e të pasur vlerash historike, kulturore, etnografike, arkitektonike e të besimeve, të tilla që përbëjnë një potencial të konsiderueshëm për turizmin. Me burimet turistike të qytetit është e mundur që të zhvillohet turizmi familiar dhe ai i organizuar. Në disa zona të rrethit (Tomor) mund të zhvillohet turizmi malor me shumë aspekte brenda tij, si edhe gjuetia.



Figura 1 – Pamje e Qytetit

2. QELLIMI I STUDIMIT

2.1 Qellimi i Pergjithshem

Qellimi i pergjithshem i ketij projekti do te jete rehabilitimi I sheshit Jani Vruho duke I sjell nje pamje te re ketij sheshi duke kryer nderhyrje te cilat rifreskojne pamjen e te gjithë sheshit dhe ne kete menyre kjo zone merr zhvillim dhe behet nje pike tjeter rekreative ne qytet. Ne kete menyre zona merr nje vlere te shtuar.

2.2 Gjendja Ekzistuese

Gjate studimit te giendjes ekzistuese, u evidentuan problematikat kiyesore qe kane nevojë te trajtohen ne kete projekt. Asfalti ne disa pjese te tij eshte I degraduar dhe rrethi qe ndodhet aty prane ka nje degradim te pllakave te shtrimit dhe veshjes ,po ashtu stolat vihen re qe jane te thyer. Mendohet te vendosen disa element te tjere shtese per ta ber me funksional. Po ashtu ka nje degradim te shtrimit ne nje pjese te shkalleve te ish-mapove.










2 IDENTIFIKIMI I PROJEKTIT


2.1 PROJEKTIMI

Gjate implementimit të Projektit "Rehabilitimi i sheshit "JANI VRUHO " janë kryer vizita të detajuara në terren ku ndërhyrjet që do të kryhen konsistojnë në shtrimin me gur të dy tipeve të ndryshme të cilët i japin një pamje të reifreskuar sheshit duke hequr asfaltin ekzistues, vendosjen e një cezme në qendër të rrethit ekzistues, pajisjen me stolë veshjen e rrethit ekzistues me pllaka dekorative dhe disa pjesë të tij me ristela druri. Fugatimi dhe pastrimi i murit të gurit si dhe shtrimi me pllaka e zonës së ish mapove.

PLANIMETRIA E SHESHIT



DETAJE SHTRIMI



DETAJ I STOLIT

